



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1427 Prot.

Tiranë, më datë 28.12.2022

VENDIM

Nr. 549, datë 28.12.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.12.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrja e vendimmarrjes e projektit Projekt restaurimi “Ujësjellësi i Bënçës”, Monument Kulture Kategoria e I-rë, me aplikues dhe zhvillues Bashkia Tepelenë;
 - a. Në projekt nuk parashikohet asnjë analizë apo ndërhyrje për restaurimin e pasurisë kulturore, e cila paraqet nevojë për ndërhyrje konsoliduese dhe restauruese;
 - b. Të plotësohet projekti grafik me planimetrinë e saktë të rrugicës që propozohet;
 - c. Të plotësohet me detaje dhe vizatimet teknike të përputhen me tipologjinë përkatëse të trasesë (në këtë rast, rrugë më kalldrëm) dhe me patologji të detajuara mbi gjendjen ekzistuese të trasesë së kalldrëmit;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Eugen KALLFANI

